

FJALA E DEPUTETES ZHENI GJERGJI

E ENJTE 7 TETOR 2021

E nderuar zonja Kryetare,

Të nderuar qytetarë,

Sapo dëgjova zonjën Felaj teksa tha: “Kush mbron jetë”? Në fakt, në këtë vend mbrojnë jetë Zoti dhe mjekët. Në këtë vend kaq të mrekullueshëm ua kemi lënë këtyre dy personave të fuqishëm: Zotit dhe mjekëve të mbrojnë jetën e njeriut. Ndaj, të jemi fillimisht falënderues ndaj të gjithë ekipit të mjekëve, kolegëve të mi, mjekë, infermierë, sanitarë, vaksinatorë, që janë heronjtë e vërtetë të këtyre ditëve të kësaj shtate të rëndë që po kalon vendi. Natyrisht, ju kërkoni përgëzime, dhe unë do t’ju përgëzoj sot për arritjen e marrëveshjes me kompaninë “Pfizer-Biotech” dhe, duke ndier një përgjegjësi të shtuar ndaj qytetarëve shqiptarë, i ftoj ata të ndërgjegjësohen, të vaksinohen sa më shpejt të jetë e mundur, me qëllim ruajtjen e shëndetit të tyre dhe të vijimësisë së jetës. Ndërsa përballemi me një të ardhme të re, vaksinat do të vazhdojnë të shërbejnë si themel i shëndetit dhe i mirëqenies për të gjithë. Vijimësia e shërbimeve rutinë të imunizimit është jetësore gjatë pandemisë së COVID-19, kërkesë e përsëritur nga Organizata Botërore e Shëndetësisë. Ndaj kjo nuk është thjesht një arritja juaj, për të cilën ju krenoheni sot, kjo është një detyrë me shumë përgjegjësi në mbrojtje të jetës së qytetarëve shqiptarë, detyrë që, në fakt, ju e keni bërë, por, natyrisht, ka vend për t’u përmirësuar dhe për këtë duhet të jeni shumë realistë.

Po, e lexova me shumë vëmendje relacionin e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale që i paraqiti Komisionit të Shëndetësisë. Dëgjova me shumë vëmendje edhe diskutimet e kolegëve të mi gjatë komisionit, që shpeshherë harronin se ishin mjekë jashtë politikës. “Krenarë për çka kemi arritur.”, deklaruat ditën e martë, zonja Ministre; dhe deklaroni edhe sot ju e kolegët tuaj. Për çfarë jeni krenarë?! Krenarë për numrin e ulët të vaksinimit? Ju nuk mund të jeni krenarë! Ju nuk mund të luani me shifra dhe nuk mund të fajësoni askënd në dështimin tuaj! “44% e popullatës target”, si ta kuptojnë njerëzit e thjeshtë popullatën target?! Në fakt, sot kemi të vaksinuar 28% të popullsisë së përgjithshme, shumë pak e krahasuar me vendet fqinje, natyrisht, nuk mund të krahasohemi me vendet europiane. Këto janë shifrat e krenarisë suaj. Na akuzuat në komision se po ju frenojmë ritmet e vaksinimit me deklaratat tona, përkundrazi, doni thjesht të hutoni popullatën. Mediet janë tuajat, portalet po ashtu, zëri është juaji! Asnjëherë nuk gjetët kurajën të realizoni një tavolinë të rrumbullakët me ekspertë të fushave të ndryshme mjekësore jashtë ngjyrave politike, në të mirë të shëndetit të popullatës! Ju planifikoni të merrni 3 milionë doza vaksinash deri në dhjetor të këtij viti, pa studime të mirëfillta të seroprevalencës, për të kuptuar mbrojtjen natyrale të popullatës para se të fillonte vjeshta dhe dimri i këtij viti. Jeni shumë të vonuar! Për çfarë jeni krenarë ju? Për numrin e ulët të vdekjeve që deklaroni?! Nuk dua të përmend shifra, se nuk dua të bëj politikë me vdekjen, se, mbi të gjitha, jam mjekë.

Shqipëria ende vazhdon të ketë rritje të vdekshmërisë totale, krahasuar me mesataren e vdekshmërisë së tremujorit të dytë të periudhës 2016-2019 para pandemisë; vendi në tremujorin e dytë të 2021-shit ka pasur një rritje të vdekshmërisë me 14%; në tremujorin e tretë vendi ynë përsëri ka rritje. Këto shifra nuk mund të fshihen, se janë alarmante. Këta numra duhet të alarmojnë Ministrinë e Shëndetësisë dhe qeverinë për një analizë të menjëhershme të të dhënave dhe për të kuptuar faktorët që kanë ndikuar në rritjen e vazhdueshme të vdekshmërisë në vend. Po kush do t’i bëjë këto analiza,

kur flasin vetëm për suksese?! Nga fillimi i pandemisë vendi ynë tashmë numëron më shumë se 16 mijë ndërrime të jetëve dhe, ashtu sikurse tregojnë edhe të dhënat e tremujorit të dytë, vdekshmëria përsëri ka ardhur në rritje. Të dhënat për vdekshmërinë e lartë na rendisin të dytët pas Maqedonisë. Këto të dhëna të rëndësishme shërbejnë për të kuptuar edhe situatën epidemiologjike sot. Infeksioni i Covid-19 dhe masat që u morën, shkaktuan ndërrime jetësh, si asnjëherë tjetër në vendin tonë, ndërkohë që ka kaluar më shumë se 1 vit e gjysmë që nga fillimi i pandemisë dhe ju ende nuk keni bërë asnjë transparencë për skemat europiane të trajtimit, që i diskutuan edhe kolegët e tjerë, pra asnjë kosto trajtimi; nuk keni bërë transparent asnjë lloj tenderi! Shqiptarët e dinë. Ata e paguan shumë shtrenjtë Covid-in jo vetëm me humbje jete, por edhe me një kosto ekonomike marramendëse, me shërbime spitalore që nuk e përballonin fluksin e pacientëve. Hapja e spitaleve rajonale Covid u bë me shumë vonesë dhe shërbimi privat me kosto të papërballueshme shkatërroi shumë familje shqiptare. Janë mijëra jetë të humbura! Njerëz të njohur, miq, kolegë, familjarë që nuk e fituan dot betejën! Dhimbje! Për të gjitha këto papërgjegjshmëri dhe abuzime, natyrisht, do të kërkoja me urgjencë ngritjen e një komisioni hetimor për të analizuar situatën e rëndë, me të cilën u përball vendi ynë për të nxjerrë përgjegjësitë e veta.

Koha shëron plagët, por, në fakt, këto plagë koha nuk ka për t'i mbyllur kurrë. Ndaj, qytetarë të nderuar, kujdesuni për veten! Vaksinohuni, se këta nuk kujdesen për ju! Faleminderit!